SONY

4-477-755-**11**(1)

Pako aksesorë

Manual përdorimi

LITHIUM ION

©2013 Sony Corporation

http://www.sony.net/

ACC-DCBX

447775511

A



B



C



D



E



Shqip

ACC-DCBX vije me aksesorët më poshtë:

ACC-DCBX
Pako bateri rimbushësh (NP-BX1) (1)
DC Karrikues për udhëtim (BC-DCX) (1)
Karrikuesi për makinë (DCC-UD10) (1)
Micro USB kordon (1)
Komplet i dokumenteve të printuar

PARALAJMËRIM

Për të shmangur rrezikun nga zjarri ose shok elektrik,
1) mos e ekspozoni aparatin në shi dhe lagështi.
2) mos vendosni gjëra të mbushura me lëngje, si vaze mbi aparatin.
Mos ekspozoni baterinë në ngrohje të tepërt si dritë dielli, zjarr ose diçka të ngjashme.

< Shënime për konsumatorët e shteteve që zbatojnë EU direktivat >
Prodhuesi i këtij produkti është Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokio, 108-0075 Japoni. Përfaqësuesi i autorizuar për EMC dhe sigurí të produktit është Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Shtutgardt, Gjermani. Për çështje servisimi ose garanci ju lutemi drejtohuni në adresën e dhënë në dokumentet e veçanta për servisim ose garancinë.

Për konsumatorët në Evropë

Largimi i pajisjes së vjetër elektrike dhe elektronike (vlejnë në Bashkimin Evropian dhe shtete tjera evropiane me sisteme të ndarë të grumbullimit)
Ky simbol në produktin ose paketimin tregon që produkti nuk duhet të hidhet bashkë me mbeturinat e shtëpisë. Në vend, duhet të dërgohet në vendin përkatës për grumbullim për riciklim të pajisjes elektrike dhe elektronike. Duke siguruar që produkti largohet mirë, do të ndihmoni në parandalimin e konsekuencave potenciale negative për mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve, e cila mund të dëmtohet nga trajtimi i gabuar i mbeturinave të këtij produkti. Materialet për riciklim do të ndihmojnë të mbrohen resurset natyrore. Për informata më të hollësishme mbi e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni zyrën lokale civile, shërbimin për grumbullimin e mbeturinave ose dyanin në të cilin keni blerë produktin.

Ky produkt është testuar dhe plotëson kushtet e vendosura në EMC direktivën për përdorimin e kordonëve lidhës më të shkurtë se 3 metra.

NP-BX1

Specifikime

Voltazhi maksimal dalës: DC 4.2 V / Voltazhi nominal dalës: DC 3.6 V / Kapaciteti: 4.5 Wh (1,240 mAh) / Temperatura e përdorimit: 0 °C në 40 °C / Dimensione (Rreth): 29.9 mm × 9.2 mm × 42.7 mm (w/h/d) / Pesha: Rreth 25 g

BC-DCX

Ju faleminderit për blerjen e Sony karrikuesit.

Para se të përdorni karrikuesin, ju lutemi lexoni këtë manual në detaje dhe ruani për të ardhmen për referencë.

Shënime mbi përdorimin

Kjo njësi nuk ka specifikime për mbrojtje kundër pluhurit, ujit ose shtrëpikjeve.

Garanci për përmbajtjen e inciznar
Përmbajtjet e incizuar nuk mund të kompensohen nëse incizimi ose dëgjimi nuk është bërë për shkak të defektit të baterisë, karrikuesit, etj.

Ku mos të vendosni këtë njësi
Mos e vendosni këtë njësi në asnjërën prej vendeve, qenë në përdorim ose në ruajtje. Nëse e bëni atë, mund të krijohet defekt.
- Në dritë direkte ose afër ngrohjes, sepse kjo njësi mund të prish formën ose të prishet.
- Ku ka dridhje të madhe.
- Ku ka fusha të mëdha magnetike ose valë.
- Ku ka tepër rërë.
Në vende si plazhe dhe pjesë tjera me rërë ose ku krijohet mjegull, mbrojeni këtë njësi nga rëra dhe pluhuri. Ka rrezik të defektit.

Paralajmërime për përdorimin

- Vendosni baterinë mirë në njësinë kur të karrikoni pakon e baterisë.
- Mos e lëshoni ose goditni njësinë.
- Mbani njësinë me larg TV pajisjeve ose AM marrësve.
Zhurma e kësaj njësie mund të penguję nëse vendoset afër.
- Siguroni që asgjë metalike vije në kontakt me pjesët metalike të njësisë. Nëse po, mund të ketë prekje dhe njësia mund të dëmtohet.
- Pakoja e baterisë dhe njësia mund të bëhet ngrohtë gjatë përdorimit ose menjëherë pas karrikimit.

Mirëmbajtja

- Nëse kjo njësi përlyhet, përdorni leckë të butë për pastrim.
- Nëse njësia përlyhet shumë, pastrojeni me leckë dhe me tretës neutral dhe pastaj pastrojeni me leckë të thatë.
- Mos përdorni hollues, benzinë, alkool, etj., sepse do të dëmtojë sipërfaqen e kësaj njësie.
- Kur të përdorni leckë kimike, shikojeni manualin e përdorimit.
- Nëse përdorni tretës si insekticid ose e mbani këtë njësi në kontakt me gomë ose produkte vinili për një kohë të gjatë, mund të shkaktoje prishje dhe dëmtim të njësisë.

Karrikimi i pakos së baterisë

Siguroni që të vendosni pakon e baterisë në karrikues para se të lidhni mikro USB kordonin.

1 Vendosni pakon e baterisë në karrikues.
Rrëshqitni kapakun e epërm të karrikuesit për të hapur.
Duke mbajtur shenjën e baterisë ▼ në drejtimin e njëjtë sikur shenja e karrikuesit ▼, vendosni pakon e baterisë në karrikues deri sa të klikojë në vend.
Rrëshqitni kapakun e epërm të karrikuesit në drejtimi ne kundërt për të mbyllur (shikoni figurën A).

2 Lidhni mikro USB kordonin (e dhënë) me njësinë, dhe pajisjen për karrkim USB (PC, USB AC karrikues). (Shiko figurën B).
CHARGE llamba (portokall) ndriçon dhe fillon karrikimi.
Kur CHARGE llamba shkyçet, karrikimi ka përfunduar.

Largimi i pakos së baterive
Largoni mikro USB korodnin nga njësia dhe pastaj rrëshqitni kapakun e epërm të karrikuesit për të hapur.
Ngadalë shtypni pakon e baterisë në drejtimin e shenjës ▼, ngritin fundin e pakos së baterisë për të larguar nga kapësja e karrikuesit, dhe pastaj largoni baterinë nga karrikuesi.
Pastaj rrëshqitni kapakun e epërm të karrikuesit për të mbyllur.

Ndihmë
DC karrikuesi për udhëtim (BC-DCX) mund të përdoret edhe si kuti mbrojtëse për mbajtjen e baterisë.

Koha e karrkimit

Pakoja e baterisë	NP-BX1
Karrikim i plotë (Rreth)	155 min (Me AC-UD10, AC-UD11) 230 min (Me PC, AC-UB10)

- Për më tepër për jetën e baterisë, shikoni manualin e aparatit tuaj.
- Koha e karrikimit mund të dallojë varësisht nga kushtet e pakos së baterisë ose temperaturës së ambientit.
- Kohëtrat e treguar janë për karrkim të baterisë së zbrazët, që është harxhuar me aparatin, duke përdorur njësinë në temperaturë ambienti 25°C.

Temperatura e karrikimit
Diapazoni i temperaturës për karrkim është 0 °C në 40 °C.
Për efikasitet maksimal të baterisë, temperatura e rekomanduar e karrkimit është 10 °C në 30 °C.

Përdorimi i pakos së baterisë shpejtë
Mund të largoni baterinë nga kjo njësi dhe përdorni madje edhe nëse nuk është mbaruar karrkimi. Mëripo, koha e karrkimit ndikon në kohën që mund të përdoret bateria.

Shënime

- Nëse CARGE llamba nuk ndriçon, kontrolloni nëse pakoja e baterisë është mirë e vendosur dhe pastaj largojeni dhe vendosni sërish mikro USB kordonin.
- Kur është vendosur bateri e karrikues plot, CHARGE llamba ndriçon njëherë dhe pastaj shkyçet.
- Një pakoo e baterisë që nuk është përdorur për një kohë të gjatë, mund të merr më tepër kohë për karrkim.
- Pakoja e baterisë gradualisht zbrazet madje edhe nëse nuk e përdorni. Karrikoni pakon e baterisë para përdorimit për mos të humbur rastet për incizim.

Mënjanimi i problemeve

CHARGE llamba (portokall) nuk ndriçon
- Bateria nuk është karrikuar plotë.
- Siguroni që mikro USb kordoni (i dhënë) është lidhur me njësinë dhe USB pajisja për karrkim.
- Lidheni njësinë drejt me PC, jo me anë të USB gllavinës, etj.
- Nëse temperatura e dhomës është jashtë temperaturës përkatëse, karrkimi ndalon automatikisht.
Kur temperatura e dhomës kthehet në diapazonin e duhur, llamba CHARGE ndriçon dhe karrkimi fillon sërish.
Ju rekomandojmë karrkimin e pakos në 10 °C në 30 °C.

Specifikimet

Hyrja e matur	DC 5 V
Dalja e matur	Terminali për karrkimin: DC 4.2 V 0.86 A
Temperatura e përdorimit:	0 °C në 40 °C
Temperatura e magazinimit:	–20 °C në +60 °C
Dimensione (Rreth)	36 mm × 70 mm × 13.5 mm (w/h/d)
Pesha	Rreth 17 g

DCC-UD10

Para se të përdorni njësinë, lexoni këtë manual në detaje dhe ruani për referencë në të ardhmen.

Me lidhjen e këtij karrikuesi për makinë DCC-UD10 me karrikuesin (Travel DC Charger BC-DCX etj.) me mikro USB kordonin të dhënë me njësinë, mund të bëni që pakoja e baterisë të karrikohet nga kyçësja e kaçamakut në makinë.
Me lidhjen e këtij karrikuesi për makinë DCC-UD10 me aparat digjital kompatibile me mikro USB kordonin e dhënë me këtë njësi, mund të bëni që aparati digjital të inciziojë deri sa aparati digjital të karrikohet nga kyçësja për kaçamak në makinë.

Për të zvogëluar rrezikun nga zjarri, mos e mbuloni ventilimin e aparatit me gazeta, lecka, perde, etj., dhe mos të vendosni qiri mbi aparatin.
Për të ulur rrezikun nga zjarri ose shoku elektrik, mos vendosni gjëra që mbushur me lëngje si vazo mbi aparatin.
Për të shmangur shok elektrik, mos e hapni shtëpizën. Lejoni që servisimin të bëjë vetëm stafi profesional/

Paralajmërime

Mbi sigurinë
- Largoni njësinë nga kyçësja për kaçamak në makinë nëse nuk përdoret për të larguar njësinë, kapeni dhe tërhiqeni njësinë. Asnjëherë mos e kapni për kordonin e njësisë.
- Nëse ndonjë lëng ose gjë e fortë bie në njësinë, largoni njësinë nga kyçësja e kaçamakut dhe pajisja dhe dërgojeni njësinë për kontroll në teknik para se të përdorni më tutje.

Instalimi

Mos e vendosni karrikuesin për makinë në vende ku:
- Ka temperaturë të lartë ekstreme.
(o.sh. në makinë me dritare të mbyllur)
- Ka dritë direkte ose afër burimit të ngrohjes.
- Ka dridhje dhe shok mekanik.
- Ka shumë pluhur.

Përdorimi

- Siguroni që priza përputhet me rrymën dhe voltazhin në karrikuesin ose aparatin digjital që doni të lidhni në karrikuesin për makinë.
- Për siguri, nëse ryma është e lartë, njësia do të shkyçet automatikisht.
- Për të ndaluar dëmtim, kujdes mos të lëshoni ose shkaktoni dridhje mekanike njësisë.
- Pas përdorimit, largoni njësinë nga kyçësja për kaçamak dhe pajisja.
- Largoni njësinë nga kyçësja për kaçamak duke e kapur vetë njësinë. Mos e tërhiqni me kordonin e lidhur me njësinë.
- Për të shmangur prekje, mos lejoni që terminalet e njësie ose lidhësit të prekin gjëra metalike.
- Kini parasysh që të dhënat e ruajtura në aparatin digjital të lidhur me këtë njësi mund të humben ose dëmtohen, nëse motori niset dhe ndalet kur njësia është vendosur në kyçësen për kaçamak.

Pastrimi

- Pastroni njësinë me leckë të thatë. Nëse njësia përlyhet shumë, pastrojeni me leckë dhe me tretës neutral dhe pastaj pastrojeni me leckë të thatë.
- Mos përdorni hollues, benzinë, alkool, etj., sepse do të dëmtojë sipërfaqen e kësaj njësie.
- Nëse përdorni pastrues kimik, lexoni udhëzimet e dhëna më produktin.
- Nëse kahita e njësisë sperkatet me ndonjë lloj të tretësi si insekticid ose mbetet në kontakt me gomë ose produkte vinili për një kohë të gjatë, mund të shkaktoje prishje dhe dëmtim të njësisë.

Përdorimi

Siguroni që të karrikoni njësinë me makinën e ndezur. Nëse njësia mbetet e kyçur në kyçësen për kaçamak në makinë kur makina nuk është ndezur, mund të harxhohet rryma nga akumulatori i makinës.

Shënime

- Siguroni që karrikuesi për makinë është instaluar mirë saqë mos të përzihet me punën e shpejtësisë ose marshin.
- Mos e lidhni kur dhe përdorni kur makina është në lëvizje.

Karrikimi i pakos së baterive (shikoni figurën C).

1 Vendosni karrikuesin për bateri në kyçësen për kaçamak.
POWER indikatori ndriçon ngjyrë gjelbër.

2 Lidhni adaptorin me karrikuesin duke përdorur mikro USB kordonin që vije me këtë njësi.
Vendosni karrikuesin në vend të sigurt.

Karrikimi i aparatit digjital (shikoni figurën D)

1 Vendosni baterinë për makinë në kyçësen për kaçamak në makinë.
POWER indikatori ndriçon gjelbër.

2 Lidheni adaptorin e makinës me aparatin digjital duke përdorur mikro USB kordonin e dhënë me njësinë.
Vendosni aparatin digjital në montuese për makinë dhe vendosni në vend të sigurt.

3 Vendosni aparatin digjital për karrkim.
Shikoni manualin e aparatit digjital për detaje.
Disa modele nuk kërkojnë rregullimet për karrkim.
- Aparati juaj digjital mund mos të jetë ai që është dhënë në këtë manual përdorimi.

Kur nuk përdorni adaptorin për makinë
Për të shmangur harxhimin e akumulatorit, largoni njësinë nga kyçësja për kaçamak kur nuk përdorni.

Kur të fikni motorin e makinës
Largoni njësinë nga kyçësja për kaçamak kur motori i makinës është fikur. Varësisht nga lloji i makinës, madje edhe nëse motori është fikur, përçimi i energjisë nuk shkyçet automatikisht. Në këtë rast, mund të shkaksohet harxhimi i kot i akumulatorit.

Shënime

- Vendosni mirë dhe fort në kyçësen për kaçamak.
- Kjo njësi mund mos të bëjë, varësisht nga vendi ose forma e kyçëses për kaçamak.
- Siguroi mirë karrikuesin e lidhur dhe aparatin digjital që mos të lëvizin madje edhe ka ndalje të shpejtë.
- Kujdes gjatë shtrirjes së USB kordonit që mos të përzihet me drejtimin e makinës, të ngatërrohet me lëvizjet e pasagjerëve ose të dëmtohet nga lëvizja e sedijes, etj.
Mos e kapni ose tërhiqni USB kordonin e dhënë nga njësia. Kjo mund të shkaktoj defekt ose të shkëputen telat.
- Mos përdorni karrikuesin ose aparatin digjital në vend që nënshtrohet lëngjeve ose lagështisë për të shmangur shok elektrik.
- Performanca nuk garantohet në rast të përdorimit të USB gllavinës ose tjetër. Ndiqni metodën e lidhës të caktuar nga karrikuesi ose nga aparati digjital.
- Kjo njësi mund të ngrohet gjatë përdorimit. Kjo nuk është defekt.

Ndryshimi i siguresës (shiko figurën E)

Nëse kjo njësia nuk punon mirë, kontrolloni siguresën në adaptorin e makinës.
Nëse siguresa është djegur, ndryshojeni.

1 Largoni njësinë nga kyçësja për kaçamak.

2 Largoni njërin skaj të kyçëses duke e rrotulluar kundër akrepave të orës.

3 Nxirreni siguresën.

4 Kontrolloni siguresën.
Nëse është djegur, kaloni në hapin 5.
Nëse nuk është djegur, kaloni në hapin 6.

5 Instaloni siguresë të re.
Përdorni siguresë me amper të njëjtë, siç theksohet në kutinë e siguresave të njësisë (1 A, 125 V, 20 mm).

6 Vendosni siguresën.

7 Kthejeni skajin e njësisë duke e rrotulluar drejt akrepave.

Shënime

- Përdorimi i amperit më e lartë mund të shkaktojë dëmtim ose zjarr.
- Mos përdorni copë teli në vend të siguresës.
- Nëse siguresa e ndryshuar digjet sërish, konsultoni distributorin.

Specifikime

Voltazhi hyrës	DC 12 V/24 V (vetëm për makina me tokëzim negativ)
Voltazhi i matur dalës	DC 5.0 V
Rryma e matur dalëse	1,500 mA
Dimensione	



Pesha Rreth 40 g

Dizajni dhe specifikimet mund të ndryshohen pa paralajmërim paraprak.